




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovac



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **21.05.2019**, me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimi më lejoni të përshëndes, nënkyetarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.. Kuorum për mbajtjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

- 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave,**
- 3. Shqyrtimi i Draft Rregullores Komunale për Transparencë,**
- 4. Informatë mbi raportin e Performancës komunale janar – dhjetor -2018,**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar.

Kryesuesi - A ka dikush të shtoj diçka rreth procesverbalit, nëse nuk ka atëherë e qes në votim Procesverbalin nga Mbledhja e Kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave.

Afram Limani – Përshëndetje për ét gjithë të pranishmit në sallë. Drejtori Limani prezantoi Qarkoren e parë buxhetore të Ministrisë së Financave për Komunën e Rahovëcit. Buxheti i komunës së Rahovëcit në bazë të qarkores së parë buxhetore për vitin 2020 do të jetë 14,735,819.00 €, grandi i përgjithshëm për komunën tonë do të jetë 5,843,393.00 €. Nëse e bëjmë një krahasim me periudhën e vitit 2019, atëherë tek grandet e kemi një rritje prej 6,12,097.00 €, kurse grandi për Këshillin e Hoçës së Madhe është 24,904.00 €, pra edhe këtu ka një rritje prej 1,410.00 €, pastaj grandi për arsim është 5,820,978.00 €, pra ka një ndryshim pozitiv në raporte me vitin e kaluar në vlerën prej 440,000.00 €. Pastaj grandi për shëndetësi 1,889,703.00 €, edhe këtu kemi një ndryshim pozitiv prej 101,463.00 €, këtu është bërë një gabim sepse sipas rregullave që llogaritet buxheti sipas formulës, këtu pra mungojnë edhe 59,000.00 €, sigurisht se këtë gabim ne do ta adresojmë tek ministria kompetente dhe me siguri ky gabim do të përmirësohet. Grandi në total është në shumën prej 14,735,819.00 €. Huamarrjen në qarkoren e parë buxhetore nuk e kemi, ne vazhdimisht kemi pasur huamarrje si në arsim dhe shëndetësi, nëse në qarkoren e dytë buxhetore do ta kemi huamarrjen, ku në arsim ka qenë 33,716.00 €, kurse në shëndetësi 134,000.000 €, atëherë buxheti do të jetë në shumën prej 14,904,000.00 € në total. Buxheti në komunën tonë ka çdo vit rritje në sajë të zhvillimit ekonomik në nivel vendi, por kjo rritje do të pozicionohet kryesisht në pozicionin e pagave për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të

ri për paga. Në bazë të analizave tona si drejtori, rritja në paga do të jetë rrëth 14%, pastaj në mallra dhe shërbime 8%, kurse kategoritë e tjera në bazë të qarkores nuk do të kenë rritje.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj së pari drejtorin e financave që na ka sjellë qarkoren e parë buxhetore, këtu janë të cekura mënyrat se si shkon ndarje e buxhetit nga Ministria e Financave për të gjitha organizatat shtetërore, po ashtu në këtë rast edhe për komunën tonë. Pyetje ime për drejtorin është: Në bazë të kësaj ndarje që ju është bërë komunës sonë në qarkoren e parë, si jeni duk e parë këtë buxhet, a është buxhet i mjaftueshëm për ti zhvilluar të gjitha aktivitetet që janë paraparë nga komuna jonë për vitin e ardhshëm. neve zakonisht problemet janë duke na u paraqitur në Drejtorin e Arsimit, sepse nuk po ka buxhet të mjaftueshëm për tu paguar pagat mësimdhënësve, a do ju mjaftojë pra ky buxhet për ti mbuluar pagat e të gjithë sektorëve si në arsim dhe sektorë tjerë. Pyetje e dytë është: A do të ketë ndryshime në mes qarkores së parë dhe qarkores së dytë buxhetore, dhe nëse po cilët do të janë ata faktorë që do të ndikojnë që të ndryshojë gjendja financiare, a është faktori njëri në komunën tonë, apo diçka tjetër. Pastaj ne si komunë ose organizatë buxhetore, ju të nderuar a e keni parashikuar realizimin e buxhetit deri në fund të viti 2019 në nivel programeve dhe nën programeve dhe projekteve tjera individuale që i kemi.

Fjolla Duraku – Përshëndetje për ét gjithë të pranishmit në sallë, falënderoj drejtorin për sqarimin që na e bërë sa i përket Qarkores së parë buxhetore. Mendoj se është për tu vlerësuar fakti që kemi rritje të pagave dhe mëditjeve nga viti 2019 në vitin 2019, këtë e vlerësoj, prandaj mendoj se duhet mbështetur kjo qarkore nga ana jonë sot dhe pastaj në mbledhje të kuvendit ta shqyrtojmë më në detaje.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të ndërlidhem me pak sa i përket Qarkores së parë buxhetore, edhe pse drejtori z. Limani i dha të gjitha sqarimet se ku do të ketë ndryshime dhe plotësime. Te arsimi shifrat që janë të vendosura tek pagat dhe mëditjet, shuma prej 272,128.52 € a janë të mjaftueshme këto shuma për ti mbuluar pagat dhe mëditjet në arsim, duke pasur parasysh rritjet e pagave si na arsim ashtu edhe në shëndetësi. Pastaj ajo që më ka bërë përshtypje është rekomandimi që është dhënë nga ana e Ministrisë së Arsimit, në mungesë të numrit të nxënësve i cili është në zvogëlim e sipër, ministria rekomandon që mos të bëhet kërkesë për hapje të konkurseve të reja, por të ju plotësohet norma atyre mësimdhënësve që e kanë norman jo të plotë. Sa është inkurajuese dhe motivuese për ata studentë që presin të diplomojnë dhe ndoshta ata janë në pritje për të u hapur ndonjë konkurs që të konkurrojnë.

Afrim Limani – I nderuari z. Fazliu në bazë të analizave të mia konsideroj se buxheti në arsim sipas kësaj qarkore është i pozicionuar edhe në paga, besoj se në vitin 2020 do të jemi më komod në krahasim me vitet e tjera, arsyeva pse e them këtë është sepse ka një rritje të konsiderueshme të buxhetit: Pastaj tre paga jubilare që kanë filluar nga viti i kaluar të kalkulohen, ne në vitin e kaluar e kemi pasur një shumë prej 21,000.00 e cila ka qenë një shumë simbolike në raport me kërkeshat që janë akumuluar ndër vite, kurse tanë në qarkoren e parë buxhetore kjo shumë do të jetë rrëth 46,000.00 €. Ne si Drejtori e Financave e kemi parë që është një hapësirë në mes qarkores së parë dhe të dytës, ne i adresojmë kërkeshat në Ministrin e Financave dhe bashkëbisedojmë me ta, ne kemi menduar që të krijohet një fond për ti mbuluar këto kategori sepse vazhdimisht kemi pasur probleme me përmbarues për këto pagesa. Pastaj ishte pyetje se a është i mjaftueshëm ky buxhet për neve karshi nevojave që dalin, të nderuar është shumë i pamjaftueshëm, do ju përmendi vetëm një shembull, ne në kuadër të Drejtorisë së Arsimit i kemi rrëth presë kontrata për ndërtimin e shkollave dhe çerdheve, prandaj realisht të gjithë buxhetin e investimeve kapitale shkon në Drejtorin e Arsimit. Por i nderuar nuk kemi çka të bëjmë sepse ky është risku jonë që është ndarë në mënyrë shumë të drejtë në bazë të një formule, por ne ndërkohë presim edhe donacione dhe burime tjera si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Pastaj ecuria e shpenzimit të buxhetit për vitin 2019, deri dje procesi i shpenzimit të buxhetit është duke shkuar shumë mirë ku mundemi të themi se deri në 50% është shpenzuar. E nderuara znj. Fahrije Lushi besoj se në bazë të përgjigjeve që ja dhashë z. Fazliu edhe juve ju jam përgjigjur, sa i përket mos shpalljes së konkursit, atë shkresë ja dërgova edhe drejtorit të arsimit. E nderuar komunën e Rahovecit gjithmonë e ka përcjellë ky problem sepse janë duke dalë disa gjëra jashtë planifikimit të buxhetit, ku ndahet një shumë e cila është e pamjaftueshme. Kurse tanë në bazë të kësaj qarkore buxhetore, nëse një mësimdhënës e ka normën e mangët atij duhet që ti plotësohen norma nëse ka nevojë edhe në dy ose tre vende të jepe mësim. Ne në vitin 2020 do të kemi një numër më të vogël të nxënësve, diku rrëth 520 nënës

më pak, dhe në bazë të analizave tona që i kemi bërë diku rreth 25-28 mësimdhënës mundën të mbesin pa punë.

Rasim Fazliu – Znj. Lushi me të vërtet e ngriti një shqetësim të madhe që e kemi të gjithë ne, e kem lexuar edhe unë me shumë vëmendje këtë, kjo është siç themi ne thikë me dy teha, ku MASHT-i rekomandon që Drejtorit e Arsimit mos të pranojnë punëtor të rinx, por të bëhet plotësimi i normave atyre që janë të punësuar. Pjetje lindë se si të i lëmë pa orë ata që vetëm janë të punësuar, kurse në anën tjetër shteti ynë është duke i shkolluar gjeneratat e reja dhe ata janë në pritje të hapjes së ndonjë vendi të punës, ky është një problem i madhe për shoqërinë tonë Kosovare dhe komunën tonë këtë rast.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e japë një përgjigje rreth pyetje së kolegut z. Rasim Fazliu dhe znj. Fajrije Lushi. Të nderuar jo decidivishtë në qarkoren e parë buxhetore thuhet se nuk duhet të shpalen konkurset e reja, ky është vetëm një rekomandim nga ana e MASHT-it.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar rreth pikës së dytë të rendit të ditës, Konstatoj se pika e dytë (2), e rendit **Qarkorja e parë buxhetore e Ministrisë së Financave** kalon në mbledhje të kuvendit për shqyrtim dhe aprovim. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Draft Rregullores Komunale për Transparencë.

Fatmir Iska - Kjo është një rregulllore komunale për transparencë, ne në mbledhjen e kaluar të kuvendit e kemi votuar Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2019-2023. Ne asgjë nuk e kemi shpikur këtu shumica e gjëra janë mare nga Ligji për Vetëqeverisje lokale, është obligative që ne si komunë të kemi këtë rregulllore. Janë disa shtylla në këtë rregulllore si: Njoftimi për publikun, prokurimi publik, qasja në dokumente publike di dhe informimi i publikut. Asgjë nuk dua më shumë të shtoj sa i përket kësaj rregulllore, nëse keni ju diçka të propozoni ose të jepni ndonjë mendim vetëm urdhëroni. Por tani kjo rregulllore një herë duhet të i kalojë siç do rregulllore tjetër të gjitha fazat e debatit publik, pastaj vjen përsëri në kuvend për shqyrtim dhe aprovim.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për ét gjithë të pranishmit, të nderuar këtë rregulllore e kam lexuar me shumë vëmendje dhe konsideroj se është gjithëpërfshirëse, falënderoj hartuesin që na ka sjellë këtë rregulllore në KPF. Por desha të japë një mendim tek pika 13 faqe nr.5 ku ceket: Për çdo tubim publik duhet të mbahet procesverbali i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, mendoj se duhet të ceket edhe numri i pjesëmarrësve për çdo tubim publik, sepse kemi raste kur në një tubim publik marrin pjesë 5-6 veta, pastaj lindë pyetje se sa janë të plotfuqishme ato propozime që dalin nga ta.

Kryesuesi - Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar edhe për pikën e tretë të rendit të ditës, konstatoj se është aprovuar që pika e tretë (3), Draft Rregullorja Komunale për Transparencë, të kalojë në kuvend për shqyrtim dhe aprovim. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Informatë mbi raportin e Performancës komunale janar – dhjetor -2018.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për ét gjithë të pranishmit, Zyrtarja e cila është e autorizuar për të raportuar sa i përket Raportit të Përformancës komunale është dashur të jetë sot prezentë, por është e angazhuar me një takim zyrtar në Prishtinë, prandaj jam detyruar që unë të ju prezantoj me këtë raport të përformancës komunale për vitin 2018: Komuna e Rahovecit është përfituese e grandit të performancës komunale për vitin 2018, ky grand ka ardhur pasi që komuna e Rahovecit i ka plotësuar 14 fusha të cilat kanë qenë kritere, dhe kjo ka ndikuar që komuna e Rahovecit të renditet e katërtë në nivel vendi. Në vitin 2017 komuna e Rahovecit nuk ka qëndruar mirë sa i përket përformancës komunale. Grandi i përformancës i ka disa module të cilat duhen planifikuar nga muaji janar – 15 shkurtë, është një data bazë ku në mënyrë online duhet të futen të dhënat në sistem. Dhe pastaj në bazë të këtyre të dhënavë dele përqindja e saktë për secilën komunë se sa i ka plotësuar fushat e dhëna.

Florida Bajraktari – Desha të bëjë një pyetje, këtu thuhet se Drejtoria e Urbanizmit e ka bërë këtë raport për performancë, mendoj se titulli në këtë raport nuk është dashur të jetë Drejtoria për Urbanizëm sepse Raporti i përformancës nuk ka të bëjë vetëm me këtë drejtori.

Fahrije Lushi Morian – Edhe unë i kisha disa vërejtje në formulimin e koncepteve, ose nuk mundemi të i quajmë as koncepte sepse këto janë më tepër referime që zgjasin dhe nuk e dinë se ku fillon dhe ku përfundon fjalia. Ky raport ka gabime të shumta drejtshkrimore dhe thjeshtë nuk qa lehtë e kuptueshme se çka ka dashur të raportoj, pe mare një shembull ku e ka cekë: Kultura, rinia dhe sporti, mendoj se duhet të

jetë: Kulturë, rini dhe sporte. Mendoj se këto gabime drejtshkrimore ja kanë humbur të gjithë kuptimin e një raporti, mua si letrare thjeshtë më kanë bërë përshtypje këto gabime, prandaj e ngrita si shqetësim, sepse nuk është hera e parë që këto informata na vijnë në këtë mënyrë. Kishte me qenë mirë që përmblledhje të kuvendit të bëhet pak rregullimi i kësaj informate sepse me të vërtet ka tekst që nuk ka pikë deri në 8 reshta.

Nënkyetari – Sa për sqarim as pikën dhe as presjen nuk dua të heqë nga ajo që e tha e nderuar znj. Fahrije Lushi, e kam parë edhe unë dhe ashtu është si e tha ajo, por duhet ta dini se zyrtarja në këtë rast për performancë nuk është letrare, komuna jonë ka mangësi për një letrarë që të bëjë rregullimin e teksteve zyrtare. Por në fund mendoj se faji nuk është i saj sepse ajo nuk i takon këtij profesioni, por ne do mundohemi që përmblledhja ta bëjmë përmirësimin.

Përparim Krasniqi – U ngritë një pyetje pse është cekur në informatë ose raporte Drejtoria e Urbanizmit, zyrtarja e cila e udhëheq grupin e performancës është zyrtare e lartë në Drejtoren për Urbanizëm, prandaj edhe e ka shkruar Drejtoria e Urbanizmit. Normalë në faqen e parë nuk duhet të figurojë ndonjë drejtori, por vetëm logoja e komunës sepse këto 14 fusha nuk janë vetëm të Drejtorisë së Urbanizmit, por janë për të gjitha drejtoritë. Por ma e rëndësishme mendoj nga të gjitha është se komuna jonë e ka fituar grandin dhe ka kaluar në vendin e katërt në nivel vendi.

Kryesuesi – Ju faleminderit, konstatoj se edhe pikë e katërt (4), Informatë mbi raportin e Performancës komunale janar – dhjetor -2018, kalon përmblledhja për shqyrtim. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Të ndryshme.

Kryesuesi – Të nderuar anëtar të KPF-së e kam një propozim që përmblledhja të jetë edhe një pikë shtesë, normalë nëse jeni edhe ju të pajtimit, Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave rreth emërtimeve të rrugëve në Komunën e Rahovecit.

Rasim Fazliu – I nderuar kryesues në mbledhjen e fundit e kemi pasur këtë problematik, ku ne kemi qenë shumë të qartë, çdo pikë shtesë duhet të prezantohet në fillim para miratimit të rendit të ditës, pastaj ajo pikë do të jetë edhe pikë e rregullt që ka kaluar në KPF. Pastaj kjo pikë nuk është shumë urgjente sepse ne me problemi e emërtimit të rrugëve jemi duke u mare qe 7-8 vite, prandaj kjo pikë ka mundur të na vije në rrugë të konsoliduar dhe me kohë, jam kundra kësaj pike shtesë, propozimi imë është që të jetë përmblledhja tjetër të radhës.

Kryesuesi - Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket pikës së fundit mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:10

Procesmbajtësi,


Skender Hamza



Afrim Dina